

Kisha—Lëvizja që vazhdon të lëvizë (pjesa 1)

Mirë se keni ardhur në festimin e kishës sonë, sot fillojmë një seri të re.

Për disa javë rresht do të flasim rreth një fjale të vetme: Kisha. Nuk e di se çfarë të vjen në mendje ose çfarë ndjenje përjeton kur dëgjon fjalën kishë. Për shumë shqiptarë, fjala kishë ka ndikim negativ. Por cila ishte ideja e kishës nga njerëzit e parë që e filluan atë?

Që në shekullin e parë, kur filloi kisha, ajo ishte një lëvizje. Nuk ishte institucion, nuk kishte liturgji, nuk kishte as tradita, akoma nuk ishte shkruar Bibla e plotë që kemi sot. Nuk kishte banera, nuk kishte banda muzikore, kompjutera, televizorë apo gjëra të tjera të tilla. Madje nuk kishin as ndërtesë të tyre, as ambiente, as staf, as hierarki. Që nga fillimi, kisha filloi si një lëvizje.

Kisha filloi shumë afër ringjalljes së Jezusit. Aty filluan ndjekësit e Jezusit, pasi ai u ringjall, panë se Jezusi ishte ashtu siç kishte thënë se ishte. Dhe ndjekësit e Jezusit ishin të parët që e filluan këtë lëvizje.

Tani, meqë është tema e parë e kësaj serie, dua të jap një kontekst për mënyrën se si filloi ideja e kishës. Do të shikojmë kuptimin e fjalës "kishë" dhe pak histori.

Fjala "kishë" ka aq ndikim negativ, saqë njerëzit na gjykojnë pa na parë ose pa na takuar. Ekziston një hendek i madh mes asaj që hamendësojnë njerëzit për kishën dhe asaj që është ajo në të vërtetë.

Dua që ta ri-mendoni kuptimin e fjalës "kishë," ta shqyrtoni ndryshe dhe ta përjetoni ashtu siç është në të vërtetë. Kisha është një lëvizje, dhe kuptimi i fjalës "lëvizje" është diçka që është në veprim e sipër, një grup njerëzish që vepron siç do të bënte Jezusi vetë nëse do të ishte fizikisht në tokë. Sot, Jezusi është fizikisht në tokë përmes kishës.

Një gjë e veçantë është se fjala për "kishë" në gjuhën origjinale greke është: ἐκκλησία (ekklesia), që do të thotë "Të Mbledhurit Bashkë" ose "të mbledhurit si bashkësi". A e di se në fillimet e demokracisë, kur u hapën kishat e para në Shqipëri, ato quheshin "Bashkësi", dhe sot në Kosovë akoma quhen "Bashkësi"?

Kur Jezusi e përdori fjalën "kishë" në Ungjillin e Mateut, misioni ishte shumë i qartë: ideja ishte "të mbledhurit bashkë". Por diçka ndryshoi gjatë historisë. Sepse më vonë, fjala "kishë" u përkthye dhe mori një kuptim të ndryshëm, jo më si një lëvizje apo grumbullim bashkë, por si një vend, dhe më pas u lidh me

idenë e një hierarkie. Nëse di shumë ose pak histori të kishës, do të vëresh se gjatë një periudhe të caktuar, kisha kaloi një fazë shumë të vështirë.

Fjala **Ekklesia** u përkthye në një fjalë tjetër në gjermanisht që ishte **Kirche**, e cila erdhi nga gotët në vitin 300 pas Krishtit. Kuptimi ishte "Shtëpia e Zotit," një vend ku bëhen rituale të besimit, pra një vend ku njerëzit vinin për të kryer rite fetare.

Nga kuptimi i **Ekklesia**, që nënkuptonte "të mbledhurit bashkë," një lëvizje njerëzish, fjala u përkthye në "kishë" si një vend, "shtëpia e Zotit," që kishte më shumë lidhje me konceptin e Dhjatës së Vjetër, tempulli. Në Izrael ekzistonte një tempull ku njerëzit vinin për të adhuruar dhe praninë e Perëndisë e ndjenin vetëm në atë tempull. Kjo e prishi krejtësisht idenë origjinale të kishës si një lëvizje.

Për më tepër, lidhja me ndërtesën bëri që ata që kontrollonin ndërtesën të kontrollonin kishën. Ata që kontrollonin ndërtesën, kontrollonin Shkrimin dhe njerëzit që vinin aty. Në disa pjesë të Evropës, ata që komandonin kishën madje kontrollonin edhe qeveritë e vendeve të tyre.

Dhe me kalimin e kohës, ajo që nisi si një lëvizje u kthye në fokus të ndërtesa, të një vend, dhe jo më të lëvizja ose të mbledhurit bashkë. Ritet e ndodhura në këto ndërtesa shpesh nuk kishin lidhje fare me kishën e parë që e nisi vetë Jezusi. Edhe sot e kësaj dite, shumica e njerëzve i referohen kishës me të njëjtën ide.

Në shekullin e 16, një djalosh studiues në Angli, William Tyndale u bë një figurë e rëndësishme për studimin e Biblës. Tyndale ishte studiues dhe gjuhëtar, dhe iu përkushtua thellësisht përkthimit të Biblës. Në atë kohë, Bibla nuk ishte e printuar; ajo ruhej vetëm në kishë dhe lexohej vetëm aty, pa qenë e mundur për të pasur një në shtëpi.

Tyndale, duke kontrolluar përmbajtjen e Biblës dhe duke vlerësuar të vërtetën që përfaqësonte, vendosi se kjo e vërtetë duhej të ishte në duar të njerëzve. Ai filloi të përkthente Biblën në gjuhën e zakonshme angleze nga gjuha origjinale hebraike dhe greke. Megjithatë, drejtuesit e kishës nuk e pranuan këtë veprim dhe e dëbuan atë nga Anglia, duke e konsideruar si të jashtëligjshëm. Ai iku në Gjermani dhe vazhdoi punën e tij të përkthimit të Biblës nga atje.

Ai printoi Dhjatën e Re dhe filloi ta fuste fshehurazi në Angli që çdo familje të kishte një Bibël në shtëpi. Kështu, njerëzit filluan të hapnin sytë pasi po e lexonin vetë Biblën. Pas disa vitesh, një nga shokët e tij e tradhtoi dhe zbuloi aktivitetin e tij. Tyndale u arrestua dhe, pasi e vranë, ia dogjën trupin.

Megjithatë, fjala kishte marrë dhenë: shumica e njerëzve kishin Biblat e tyre, dhe fuqia e drejtuesve të kishave filloi të bjerë, sepse njerëzit mund të lexonin vetë Biblën.

Ajo që i shqetësoi më shumë drejtuesit fetarë ishte se Tyndale kishte përkthyer fjalën "kishë" si **Ekklesia**, që nënkuptonte "grumbullim njerëzish bashkë" ose "bashkësi", në vend të konceptit të një ndërtese. Ky përkthim i përfshinte njerëzit si një grup që mbledhesh rreth një mesazhi të përbashkët: besimi në atë se Jezusi erdhi, vdiq dhe u ringjall sipas Shkrimeve, siç kishte thënë edhe vetë Jezusi.

Në Ungjillin e Mateut, Jezusi mbledhi dishepujt e tij dhe u bëri një pyetje të thjeshtë: "Çfarë thonë njerëzit për mua?" Dishepujt përgjigjën duke thënë se disa mendonin se Jezusi ishte Gjon Pagëzori që ishte ringjallur, disa të tjerë e mendonin si një nga profetët e Dhjatës së Vjetër, si Elia ose Moisiu.

Por Pjetri tha, "A ta them se kush mendoj unë se je ti: Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së Gjallë." Jezusi iu përgjigj Pjetrit dhe tha:

Mateu 16:17 *'Dhe Jezusi duke përgjigjur u tha: "I lum je ti, o Simon, bir i Jonas, sepse këtë nuk ta zbuloi as mishi as gjaku, por Ati im që është në qiell.'*

Mateu 16:18 *'Dhe unë po të them gjithashtu se ti je Pjetri, dhe mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin atë.'*

Jezusi tha: "Nuk do të ndërtoj një objekt, do të ndërtoj Ekklesia; do të ndërtoj të mbledhurit bashkë, do të ndërtoj lëvizjen e madhe. " Kjo do të thotë se kjo gjë do të vazhdojë shekull pas shekulli, sepse kisha lindi si një lëvizje njerëzish të lidhur nga një mesazh i thjeshtë, jo rreth një objekti.

Pasi tha këto gjëra, Jezusi u kryqëzua. Por ai u ringjall nga vdekja dhe kaloi 40 ditë me dishepujt e tij. Pas këtyre 40 ditëve, ata u mbledhën në malin e Galileës dhe Jezusi u dha udhëzimet e fundit. Në Ungjillin e Mateut, kjo quhet "Porosia e Madhe," dhe në Veprat e Apostujve përshkruhen hapat e fillimit të kishës. Jezusi tha, "Unë po e filloj, po bëj Grand Opening të kishës së parë, e bazuar në një ide të vetme: që Jezus Krishti është Biri i Perëndisë së Gjallë."

Disa nga fjalët e fundit të Jezusit atë ditë para se të ngjitej në qiell ishin:

Veprat e Apostujve 1:6 *'Kështu ata që ishin mbledhur bashkë e pyetën, duke thënë: "Zot, a do ta rivendosësh në këtë kohë mbretërinë e Izraelit?".'*

Nuk po mendonin për rritjen e kishës, por mbretërinë në tokë.

Veprat e Apostujve 1:7 *'Por ai u tha atyre: "Nuk ju takon juve të dini kohët dhe momentet e përshtatshme, që ka përcaktuar Ati me autoritetin e vet.'*

Veprat e Apostujve 1:8 *'Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut''.'*

Nuk e dimë çfarë kanë menduar, por do t'ju ketë bërë përshtypje fjala "FUQI". Fuqia është diçka e mirë, një fuqi e madhe për ne. Ndërsa fjala "dëshmitar" është e dëmtuar gjithashtu kur vjen puna te besimi, sepse shpesh lidhet me dëshmitarët e Jehovait. Por nuk është ky kuptimi i saj origjinal; fjala "dëshmitar" ka kuptimin e dikujt që dëshmon në gjyq, dikush që jep dëshmi për atë që ka parë sepse ka qenë prezent në një ngjarje ose ka dëgjuar atë që tha dhe bëri një person.

Ata duhej të shpërndanin mesazhin e Tij nga Jerusalemi, aty ku ishin, në Jude, që ishte një zonë më e gjerë, në Samari, një vend ku askush nuk dëshironte të shkonte, dhe deri në fund të botës.

Tani, nuk e dimë se çfarë kanë menduar këta burra, por le ta imagjinojmë vetë ne. Ke përpara dikë që Romakët e kishin kryqëzuar, gjithë partia e urrente dhe je aty bashkë me 100 burra të tjerë. Dhe Ai tha: "Çuna, ja se çfarë do të ndodhë. Ju do t'i dërgoni mësimet e mia, mesazhin tim, faktin që unë u ringjalla, do shkoni dhe nuk do të lini njeri në Jeruzalem pa i thënë për këtë gjë."

Dhe ata kanë parë njëri-tjetrin, "Dakord, në Jeruzalem do shkojmë, se njohim disa djem që do na ndihmojnë. Kam shok njeriun që ka disa salla bosh dhe do bëjmë koncerte dhe do i ftojmë të gjithë, dhe aty do u themi që po bëhet kjo punë në Jeruzalem, madje edhe në Jude do shkojmë. Po në Samari, jo, unë nuk shkoj për vete, por do shkojë ndonjë nga këta të tjerët, as deri në fund të botës. Le që te kjo e fundit do kenë menduar: "Çuna, çfarë po thotë ky? Unë s'kam shkuar akoma deri në fund të Shqipërisë, e di që quhet nga Vermoshi në Konispol, por se ku bien këto dyja nuk e di."

Ndonjë mund të ketë ngritur dorën dhe të ketë thënë: "Jezus, a e ke idenë ti se sa e madhe është bota që na thua të shkojmë deri në fund të saj?" Dhe Jezusi do t'u ketë thënë, - po e improvizojmë këtu, sepse nuk është fjalë për fjalë kështu në shkrim - "Në fakt, ju nuk e dini sa e madhe është bota. Ju e njihni vetëm Perandorinë Romake, por mesazhi im, kjo lëvizje, kjo bashkësi, ky vrull që do krijohet këtu, do të përhapet dhe do të prekë çdo krijesë të kësaj bote. Do të fillojë nga ti, do të fillojë nga ata që ke afër dhe do të shkojmë gradualisht cep më cep të botës, madje edhe në Shqipëri do të shkojë ungjilli."

Në fakt, kjo është profecia me kuptim të thellë, sepse në një farë mënyre ne jemi pjesë e përmbushjes së kësaj profecie.

Kur mbaroi, Jezusi u ngjit para syve të tyre në qiell dhe më pas, diku rreth 120 burra u mblodhën në Jeruzalem dhe filluan të luten, të luten, e të luten. Pas dy javësh ndodhi diçka e paimagjinueshme deri atëherë gjatë festës së Pentakosit, ku kishin ardhur Judej nga shumë anë të botës.

Shkrimi na thotë se, kur 120 burrat po luteshin, Fryma e Shenjtë u derdh mbi ta me fuqi, siç kishte thënë Jezusi, dhe ata ishin në gjendje të flisnin gjuhë që çdo Jude dhe person në sheshin e Jeruzalemit që kishte ardhur për festën e Pentakosit e kuptonte. Njerëzit që kishin ardhur u habitën: "Si është e mundur që këta flasin gjuhët tona, dialektet nga vijnë ne?"

Dhe për çfarë po flasin? Për një Jezus që u kryqëzua dhe është ringjallur përsëri. Kjo situatë trazoi gjithë Jeruzalemin.

Njëri i tha tjetrit, që i tha tjetrit, dhe ja ku u mblodh i gjithë qyteti. Disa filluan të talleshin: "Këta janë bërë tapë në pikë të mëngjesit! Ju kam thënë mos pini rakinë e kafes së lagjes që në mëngjes, se ju zë; është raki e fortë ajo."

Disa thoshin: "Prit, të dëgjojmë se flasin dialektin e fshatit tim."

Pjetri e ndau mendjen: "O sot, o kurrë." U çua dhe predikoi në shesh. Dhe atë ditë, në atë shesh, filloi kisha e parë. Jezusi e kishte parashikuar: do të ndodhte një grumbullim, Ekklesia, dhe ndodhi, ata u grumbulluan. Pjetri predikon për herë të parë. Ishte Grand Opening i kishës së parë, Big Bang-u i kishës së parë. Pjetri bëri lidhjen e Dhjatës së Vjetër me atë të Re që audienca ta kuptonte vetë dhe u tha: "Nuk ka gjë për t'u habitur; Perëndia e pati premtuar këtë gjë."

Veprat e Apostujve 2:22-23 *'Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë: Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë të ti tij, siç edhe vet e dini, ai, pra, sipas këshillit të caktuar dhe të paranjohur të Perëndisë, ju dorëzua juve dhe ju e zutë dhe, me duart e të padrejtëve, e gozhduat në kryq dhe e vratë.'*

"Ju që po habiteni kaq shumë, sepse këta po ju flasin në gjuhët që ju i kuptoni, po ju them edhe unë një herë troç e qartë." Ajo që po thoshte Pjetri kishte ndodhur afër, diku rreth 2 muaj më parë, dhe kishte pasur njerëz aty që kishin thënë: "Po, e mbaj mend kur e rrahën atë burrë dhe iu desh të mbante vetë kryqin mbi kraharor deri në kodrën e Golgotës. Kam dëgjuar për këtë Jezus edhe më parë; ai shëroi një kushëririn tim që kishte lindur i verbër, dhe gjithë

fisi ynë e mban në gojë. Po ky është Jezusi nga Nazareti. Nuk ishte histori e para disa shekujsh, por e para 2 muajsh, histori e freskët."

Veprat e Apostujve 2:23-24 *'ai, pra, sipas këshillit të caktuar dhe të paranjohur të Perëndisë, ju dorëzua juve dhe ju e zutë dhe, me duart e të padrejtëve, e gozhduat në kryq dhe e vratë. Por Perëndia e ka ringjallur, pasi e zgjidhi nga ankthet e vdekjes, sepse nuk ishte e mundur që vdekja ta mbante atë.'*

Pjetri troç dhe qartë predikoi vetëm për vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit, ky ishte mesazhi.

Veprat e Apostujve 2:32 *'Këtë Jezus, Perëndia e ka ringjallur; dhe për këtë të gjithë ne jemi dëshmitarë!'*

I mbani mend këto fjalë, "Ju do të jeni dëshmitarë," ashtu siç tha Jezusi. Ai tha: "Ju do të jeni dëshmitarë." Pjetri tha: "Ne jemi dëshmitarë që Ai u kryqëzua dhe ne jemi dëshmitarë që Ai është i gjallë përsëri, para dy muajsh. Ne po ju dëshmojmë fakte, jo fjalë të bukura, oratori të kuruar nga ndonjë Guru i famshëm. Jo, jo, janë fjalë të thjeshta por reale; e pamë dhe po ju dëshmojmë."

Veprat e Apostujve 2:33 *'Ai, pra, duke qenë i ngritur në të djathtë të Perëndisë dhe duke marrë nga Ati premtimin e Frymës së Shenjtë, ka përhapur atë që ju tani shihni dhe dëgjoni.'*

Shokë, kjo është nga Perëndia, jo nga ne.

Veprat e Apostujve 2:36 *'Ta dijë, pra, me siguri, gjithë shtëpia e Izraelit se atë Jezus që ju e keni kryqëzuar, Perëndia e ka bërë Zot e Krisht'.'*

(Krisht, i vajosur, i zgjedhuri i Perëndisë)

Kjo ishte troç fare, dhe ka mundësi që ka rënë qetësi e madhe. Dhe në mes të qetësisë dikush merr guxim dhe pyet:

Veprat e Apostujve 2:37 *'Kur ata i dëgjuan këto gjëra, u pikëlluan në zemër dhe pyetën Pjetrin dhe apostujt: "Vëllezër, ç'duhet të bëjmë?"'*

"Vëllezër? Ku të gjeta unë ty? Në bahçe të gjeta? Po, mor, tani që u mblodh fija, vëlla e xhan e shpirt na keni ju... por është vonë, o të keqen, vëllai," apo nuk i tha kështu Pjetri?

Vëllezër, çfarë të bëjmë? Pjetri, "Duhet të vini çdo të diel në festimet e kishës sonë, mos mungoni ndonjë të diel, se do t'ju shikoj. Duhet të sillni pastorit ndonjë gjë të mirë sa herë që vini; çokollata Milka ka qejf, ato do sillni sa herë që vini në kishë. Jo, prit duhet..." Po qeshni sepse kuptohet që nuk është në

Bibël kjo. Kisha nuk është ndërtesa; kisha e parë nuk kishte ndërtese fare, ishin në shesh, mes sheshit, aty ishte kisha. Cila ishte kisha e parë? Ishte Ekklesia: të mbledhur bashkë për të dëgjuar një mesazh të vetëm dhe, pasi ta kishin dëgjuar, ta shpërndanin tek të tjerët. Si vazhdon...

Veprat e Apostujve 2:38 *'Atëherë Pjetri u tha atyre: "Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezus Krishtit për faljen e mëkateve, dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë.'*

Premtimi ishte, se nëse pendohesh, do të të falen mëkatet.

Veprat e Apostujve 2:39 *'Sepse premtimi është për ju dhe për bijtë tuaj dhe për gjithë ata që janë larg, për ata që Zoti, Perëndia ynë, do t'i thërrasë'.'*

Premtimi i Frymës së Shenjtë është për të gjithë ata që janë larg. Kush ishin ata që ishin larg? Premtimi ishte për ty, për mua, për fëmijët tanë, nipërit dhe mbesat, ata që janë larg. Në një mënyrë, Pjetri po thoshte: "Kjo nuk është vetëm për ju këtu në Jeruzalem, nuk është vetëm për këtë brez, nuk është vetëm për ne. Kjo që po fillon mes nesh, ky mesazh, kjo lëvizje, kjo ide, kjo fuqi mbinatyrore që patë dhe po përjetojmë sot, çdo gjë, është për ne, për bijtë tanë dhe për ata që janë larg."

Brezat kanë ardhur e kanë ikur, por kjo lëvizje ka vazhduar brez pas brezi. Ky brez do të vdesë një ditë dhe do të rritet brezi i ri, por vrulli i kishës do të vazhdojë, do të ecë përpara sepse është mesazh për shumë breza.

Pastaj ishte koha për lutjen e shpëtimit. E ke parasysh lutjen e shpëtimit në fund të mesazhit? Aty, në mes të sheshit, kishte aq shumë energji dhe prekje nga Fryma e Shenjtë, aq sinqeritet dhe pastërti, aq gati ishin njerëzit të besonin Zotit, sa nuk bëhej më ndryshe. Nga e dimë? Vargu tjetër...

Veprat e Apostujve 2:41 *'Dhe ata që e pranuan fjalën e tij me gëzim, u pagëzuan; atë ditë u shtuan rreth tre mijë veta.'*

Dhe atë ditë u pagëzuan. Ka mundësi që dishepujt kanë qenë në lumin Jordan për ditë të tëra duke pagëzuar njerëz që thoshin: "Kthehemi nga rrugët e vjetra dhe vendosim të besojmë Jezusit sot dhe nuk kemi turp ta marrin vesh gjithë qyteti."

Sepse, për të qenë të sinqertë, Jeruzalemi nuk ishte ndonjë qytet i madh në atë kohë; mendohet se kishte diku rreth 40 mijë banorë, sa një lagje e Tiranës. A mund ta imagjinosh se çfarë energjie është krijuar në qytet me 40 mijë banorë, ku 3 mijë zgjodhën brenda një dite të besonin? Çfarë vrulli, çfarë rryme, që nga fillimi filloi një ngjarje e madhe. E di që disa nuk i kanë qejf kishat e mëdha,

por a nuk do të ishte një gëzim i madh për ne që në ditën e parë të hapjes të kishte mijëra pjesëmarrës dhe 3 mijë veta të besonin?

Ata që nuk kanë qejf kishat e mëdha por preferojnë kisha të vogla, si do të ishte në qiell? Do të jemi të gjithë bashkë, apo do të ketë dhoma për grupe të vogla edhe atje? Nuk e di.

Ajo që duket qartë është se fillimi i kësaj kishe ishte i madh, ishte i dukshëm, ishte i fuqishëm, dhe 3 mijë veta besuan mesazhin që Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë. Ai u kryqëzua nga Romakët, por u ringjall, dhe Pjetri dhe shokët e tij ishin dëshmitarë të kësaj ngjarjeje.

Ata që u penduan, u bënë pjesë e këtij grumbullimi të ri, kësaj bashkësie të re që më vonë do të njihej si kisha lokale. Ndodhi ashtu siç tha Jezusi, dhe tani, pas 2 mijë vjetësh, ja ku jemi sot.

Dhe a e di se çfarë kanë të përbashkët të gjithë të krishterët në botë? Bota sot ka 7.4 miliard njerëz dhe 2.6 miliard, 1/3 e botës, janë të krishterë. Çfarë kemi të përbashkët?

Nuk kemi adhurimin, sepse stilin e muzikës e ndajnë kishat katolike dhe ortodokse që kanë liturgji të ndryshme. *Hiqe qiriun, se më dogje mjekrën—kush e di këtë batutë? - Amen.*

Nuk janë traditat ose mënyra e të bërit kishë. E vetmja gjë që kemi të përbashkët është besimi se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë, i cili erdhi në tokë, vdiq për të paguar për mëkatet tona dhe u ringjall pas tre ditësh, siç kishte thënë. Vetëm kaq, dhe kaq mjafton.

Një gjë e veçantë për kishën e re, kishën e parë, është se, edhe pse kisha ka kaluar nëpër situata të vështira që nga Koha e Perandorisë Romake e deri sot, ajo ka mbijetuar. A e di se shekulli 21 është shekulli ku janë persekutuar dhe vrarë më shumë të krishterë se në çdo shekull tjetër? Por, përsëri, kisha është në këmbë.

Lajmi i mirë ka shkuar cep më cep të botës; Bibla është shkruar dhe përkthyer në çdo lloj gjuhe të botës. Që nga fillimi, ka pasur misionarë që kanë shkuar për të folur të tjerëve për Jezusin në vende të tjera. Janë bërë përkthime të Biblës, ka pasur ungjillorë të shumtë, pastorë dhe predikues. Ka pasur njerëz që kanë shërbyer dhe ndihmuar në shumë, shumë forma në emër të Jezusit.

Edhe pse shumë kisha janë kthyer me fokus nga ndërtesa, gjithmonë ka pasur një grup të madh të krishterësh që kanë thënë: "Nuk ka lidhje me ndërtesën, nuk

ka lidhje me hierarkinë, nuk ka lidhje me kontrollin. Shkrimi është për të gjithë." Gjithmonë ka pasur njerëz si William Tyndale që kanë thënë: "Jam gati të jap jetën time vetëm që historia e Jezusit, Bibla, të jetë në duar të njerëzve, që ata ta lexojnë dhe ta kuptojnë qartë atë, dhe të thonë: 'Ueee, çfarë Perëndie genka ky! Unë dua t'i besoj këtij Perëndie.'"

Ka pasur shumë të krishterë që kanë thënë: "Ne nuk duam të kthehemi në Dhjatën e Vjetër ku, për t'u lutur, të duhet një person tjetër, një ndërmjetësues."

Ka pasur shumë të krishterë që kanë kuptuar se ne jemi tempulli i Perëndisë. Kur Fryma e Shenjtë erdhi në Ditën e Pentakostit, u vu në dispozicion të çdo personi që e dëgjon dhe e pranon mesazhin e Jezusit—që ti je tempulli i Perëndisë. Ai banon brenda teje. Ti je ndërtesa, ti je kisha aty ku je, aty ku ndodhesh gjatë ditës.

Dhe kur mblidhemi në emrin e Jezusit, jemi pjesë e asaj që quhet kishë, e cila përfshin njerëz me dashurinë dhe pasionin për Jezusin, si kisha në ditën e parë, si kisha në Jeruzalem.

E di pse më pëlqen kjo kishë? Sepse ka njerëz që i dinë shumë qartë këto gjëra që po them sot. Ka njerëz që, kur shikojnë dikë që pagëzohet, gëzohen bashkë me të, sepse e dinë se edhe një më shumë hyri në mbretërinë e Perëndisë.

Njerëz që takohen në grupe të vogla gjatë javës, sepse kur ata mblidhen në grupe të vogla, ata janë kishë në atë moment. Kisha po ndodh aty. Sa herë që je bashkë me 2-3 besimtarë në punë, në kafe, në shtëpi, këtu, aty, po ndodh kisha.

Dhe sa herë që bëni diçka bashkë për dikë, për fëmijët ose për ndonjë kategori tjetër njerëzish, ti je kishë në veprim.

Dhe sa herë që shërben në një nga gjërat që ndodhin në kishë—te fëmijët, te rinjtë, studentët, mikpritja, muzika, shërbimet praktike, media, skena, projektet sociale, çdo gjë—ti je kishë, aty po ndodh kisha.

Gjithmonë do të ketë të krishterë që do e kuptojnë shumë qartë: kisha nuk është ndërtesa, kisha është aty ku janë njerëzit. Kisha është aty ku njerëzit mblidhen rreth një ideje të qartë dhe të thjeshtë: Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë së Gjallë. Ai erdhi, vdiq në kryq për mëkatet tona, u ringjall të tretën ditë dhe kush beson është i shpëtuar. Ky mesazh ngelet i njëjtë dhe i pandryshuar për ne, për Tiranën, për Shqipërinë, për gjithë shqiptarët, për gjithë botën.

Nuk e di se çfarë të vjen në mendje ty ose çfarë ndjesie përjeton kur dëgjon fjalën "kishë." Por shpresoj që, për shkak të kësaj që ke dëgjuar sot, do kesh një

ide më të qartë. Shpresoj që do të jetë e qartë një herë e përgjithmonë që kisha nuk është një vend, një ndërtesë—kishë ndodh aty ku ka njerëz. Kisha është një lëvizje, sepse lëviz aty ku lëvizin njerëzit; është një lëvizje që akoma lëviz, një lëvizje me një vrull të jashtëzakonshëm. Dhe uroj që sa herë që mblidhemi bashkë si Trupi i Krishtit, nuk do ta harrojmë që jemi në tokë për të njëjtën arsye për të cilën filloi kisha e parë.

Javën tjetër do të vazhdojmë aty ku e lamë, te Veprat e Apostujve, kapitulli 2.

E di se çfarë dua të bëj këtë javë: po sikur ta lexoni një herë të gjithë Veprat e Apostujve? Ato vijnë menjëherë pas Ungjillit të Gjonit në Dhjatën e Re.

I jam mirënjohës Perëndisë që pati burra si William Tyndale dhe Gjerasim Qiriazit dhe të tjerë si ata, prej të cilëve secili mund të ketë një Bibël në shtëpi dhe ta lexojë në gjuhën e tij. Nuk ke pse të presësh të dielën që ta lexosh nga unë, apo që të dalë në ekran.

Kisha gjithmonë do të ketë një grup njerëzish që e kanë të qartë idenë: kisha është Ekklesia, të mbledhurit bashkë; është kisha lokale në lëvizje. Kisha ekziston për të reflektuar vetëm një gjë, vetëm një ngjarje, vetëm një mesazh, dhe kjo ka ndryshuar dhe do të ndryshojë botën.

Lutja ime është që ne do të jemi gjithmonë një kishë që është duke bërë saktësisht atë që Perëndia dëshiron të ndodhë në këtë qytet, në këtë vend.

Le të lutemi.